



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORTI I MONITORIMIT TË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

JANAR-QERSHOR 2010

Korrik, 2010

Hyrje

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës të Republikës së Kosovës është rregulluar statusi juridik i Pushtetit Lokal. Komunave, si njësi themelore të Vetëqeverisjes Lokale, iu është njohur shkallë e lartë e Vetëqeverisjes, e cila duhet të udhëhiqet nga parimet kushtetuese, të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale si dhe në përputhje me parimet e konventave të tjera, të cilat janë të parapara me Kushtetutë.

Pushteti lokal në Kosovë ka njohur zhvillim të vazhdueshëm që pas vitit 1999, duke arritur deri në vitin 2008, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës, kur u hodh edhe një hap tjetër i madh i reformës së pushtetit lokal dhe avancimit të autonomisë së Komunave.

Ligji për Vetëqeverisje Lokale përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.

Misioni i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është avancimi i qeverisjes lokale, të bazuar mbi parime të transparencës, efikasitetit, efektivitetit, në ofrimin e shërbimeve efikase, pa diskriminim dhe sa më afër qytetarëve.

Në bazë të mandatit që ka Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, obligohet të mbikëqyrë ligjshmërinë e veprimeve që ndërmerr komuna, në mënyrë që ato të mos bien ndesh me LVL-në, ligje të tjera dhe të mos cenojnë të drejtat e qytetarëve. Me qëllim të mbështetjes së komunave gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, MAPL, gjegjësisht Divizioni i Monitorimit në kuadër të Departamentit për Vetëqeverisje Lokale, vazhdimisht monitoron seancat e kuvendeve komunale. Në këtë drejtim, përveç monitorimit, si mekanizëm për evidencimin e shkeljeve eventuale nga ana e komunave gjatë nxjerrjes së akteve normative komunale apo miratimit të vendimeve, Divizioni i Monitorimit adreson shkeljet në Departamentin Ligjor të MAPL-së, për të bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së këtyre akteve.

Ky raport i funksionimit të Komunave për periudhën janar-qershor 2010 vjen si rezultat i detyrimit ligjor që ka Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në lidhje me Komunat, por edhe si një mjet tjetër për të shtuar transparencën në lidhje me aktivitetet e pushtetit lokal.

Raporti përfshin të dhëna, në lidhje me funksionimin e Kuvendeve të Komunave, efikasitetin dhe azhuritetin e organeve administrative komunale.

Po ashtu, Raporti përmban edhe të dhëna të përgjithësuara krahasuese në lidhje me mbledhjet e Kuvendeve të Komunave.

Ky raport ka për qëllim të hulumtojë situatën aktuale dhe sipas të dhënave të grumbulluara të pasqyrojë gjendjen reale në lidhje me funksionimin dhe aktivitetet e Komunave.

Raporti përmban të dhëna për 33 komuna të Republikës së Kosovës, ndërkohë që për komunat e Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan nuk kemi pasur të dhëna.

Qëllimi

Qëllimi i raportit ka të bëjë me pasqyrimin e punës dhe të aktiviteteve të ndërmarra nga komunat e Republikës së Kosovës, pas përfundimit dhe certifikimit të zgjedhjeve, të mbajtura në nëntor të vitit 2009 e deri në qershor të vitit 2010. Duke pasur parasysh se pas përfundimit të këtyre zgjedhjeve, ka ndryshuar përbërja e kuvendeve komunale si dhe ekzekutivit, ky proces është përcjell me shumë kujdes nga ana e MAPL-së. Si rezultat i kësaj, në këtë raport ofrohen të dhëna të sakta lidhur me procedurat, të cilat i kanë paraprirë konstituimit të kuvendeve dhe qeverive komunale si dhe hapave të tyre të ndërmarra në drejtim të implementimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ligjeve të tjera si dhe akteve nënligjore. Zyrtarët e MAPL-së, përkatësisht Divizionit të Monitorimit, në vazhdimësi marrin pjesë në seancat e rregullta të kuvendeve të komunave, duke evidencuar ecurinë e punës së kuvendeve komunale në kontekst të zbatimit të drejtë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Përmbajtja e Raportit

- Konstituimi dhe funksionimi i kuvendeve komunale
- Mbledhja inauguroese
- Betimi I anëtarëve të Kuvendit të Komunës
- Zgjedhja e kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesi për komunitete
- Zgjedhja e Zëvendëskryesuesi për komunitete
- Funksionimi i Kuvendit të Komunës
- Seancat e Kuvendit të Komunës
- Konfliktet e interesit
- Aktet e Kuvendit të komunës
- Rregullorja për përdorimin e gjuhëve
- Transparenca
- Rregullorja për transparencën
- Marrëveshjet ndërkomunale dhe të jashtme
- Funksionimi i komiteteve të kuvendeve të komunave
- Komitetet e obligueshme
- Komiteti për Politikë dhe Financa
- Komiteti për Komunitete
- Komitetet tjera
- Komitetet Konsultative
- Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
- Udhëheqësia komunale - ekzekutivi
- Zgjedhja e kryetarit të komunës
- Emërimi i nënkryetarit të komunës dhe nënkryetarit të komunës për komunitete
- Drejtoritë komunale
- Konfliktet e interesit
- Shkeljet ligjore të komunave
- Efikasiteti i organeve administrative
- Konkluzione
- Rekomandime

Përmbledhje ekzekutive

Raporti për funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës është hartuar në bazë të të dhënave të mbledhura nga monitorimi i komunave dhe plotësimi i pyetësorëve, të hartuar nga MAPL-ja, për funksionimin e organeve komunale dhe respektimin e dispozitave ligjore.

Ky raport paraqet të dhënat për 33 komuna funksionale të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar kështu komunat e veriut të Kosovës të banuara me shumicë serbe, për shkak të mos themelimit dhe mos bashkëpunimit të organeve të ligjshme lokale.

Në këtë raport janë paraqitur të dhëna lidhur me funksionimin e kuvendeve komunale, numrin e mbledhjeve të mbajtura dhe aktet e miratuara si dhe funksionimin e komiteteve obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete, krijimin dhe funksionalizimin e komiteteve të tjera dhe komiteteve konsultative të rregulluara sipas LVL-së, Ekzekutivin e Komunës si dhe Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.

Nga raporti mund të shohim se shumica e komunave janë në përputhje me LVL-në sa i përket mbajtjes së mbledhjeve të mbajtura gjatë periudhës së parë të vitit 2010, duke respektuar nenin 43 pika 2 për mbajtjen e së paku pesë mbledhjeve në gjashtëmujorin e parë të viti.

Shumica e komunave kanë miratuar aktet të e rëndësishme ligjore që kërkohen me ligj, si plotësimet e Statuteve, Rregulloret për punën e kuvendit, Rregullore komunale si Rregulloret komunale për transparencën, Rregulloret Komunale për Gjuhët si dhe Rregullore të tjera.

Përveç komunës së Prizrenit ku nuk janë themeluar komitetet obligative dhe komunës së Glllogocit ku nuk është themeluar Komiteti për Komunitete, në të gjitha komunat e tjera janë themeluar këto komitete, ai për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete.

Konstituimi dhe funksionimi i Kuvendeve Komunale

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kuvendi i komunës është organi më i lartë në komunë. Kuvendet e Komunave të Republikës së Kosovës, kanë numër të ndryshëm të anëtarëve dhe kjo varet nga numri i popullsisë në komunë. Për dallim nga komunat tjera, meqë qyteti i Prishtinës ka numër më të madh të banorëve, edhe me LVL-në është paraparë që Kuvendi i Komunës së Prishtinës t'i ketë 51 anëtarë.

Mbledhja inauguroese

Më 15 nëntor 2009 janë mbajtur zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës në 33 komuna.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-40 nenit 42.1, Kuvendi i Komunës mban mbledhjen inauguroese brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

Sipas të dhënave të prezantuara në raport, rezulton se në 33 komuna, pas përfundimit dhe certifikimit të rezultateve zgjedhore, seancat inauguroese janë konvokuar në pajtim me nenin 42 të LVL-së, duke i bërë ato funksionale.

Që të gjitha komunat kanë mbajtur me kohë mbledhjen inauguroese. Në pajtim me nenin 42 të LVL-së, mbledhjet janë thirr nga kryetari i komunës, brenda afatit ligjor, të cilat në vijim janë kryesuar nga anëtari më i vjetër i kuvendit komunal deri në zgjedhjen e kryesuesit të ri.

Betimi I anëtarëve të kuvendit

Betimi i anëtarëve të kuvendeve të komunave të Republikës së Kosovës është bërë në përputhje me nenin 35. 4 të LVL-së, sipas të cilit nen, të gjithë anëtarët e kuvendit obligohen që të nënshkruajnë betimin solemn. Përrjashtim nga kjo bën komuna e Gjakovës dhe Malishevës, të cilat nuk kanë respektuar normën në fjalë. Kjo si rezultat i mosrespektimit të afatit ligjor 1 muhor për dhënien e betimit, siç e parasheh neni 35.5 i LVL-së. Me qëllim të dhënies së mundësisë për të qenë pjesë e kuvendit komunal, në komunat ku nuk është respektuar afati ligjor për

dhënie të betimit, MAPL ka dërguar një shkresë, në të cilën ka përcaktuar një afat shtesë për dhënien e betimit.

Zgjedhja e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit për komunitete

Bazuar në nenin 41 të LVL-së i cili rregullon procedurën e zgjedhjes së kryesuesit të Kuvendit të Komunës, të gjitha komunat kanë zgjedhur kryesuesin e kuvendit në përputhje me të gjithë paragrafët e këtij neni.

Për dallim nga komunat tjera, vetëm Komuna e Gjakovës dhe Novobërdës e kanë zgjedhur Kryesuesin e Kuvendit nga radhët e gjinisë femërore, që do të thotë se është në përputhje me politikat e integritetit të komunitetit femëror në proceset vendimmarrëse.

Zgjedhja e zëvendëskryesuesit për komunitete

Sipas LVL-së, komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve jo shumicë, posti I zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve.

Komunat të cilat kanë zgjedhur zëvendëskryesues të kuvendit për komunitete janë: Gjakova, Shtërpca, Mitrovica, Peja, Prishtina, Obiliqi, Novobërda, Dragashi, Prizreni, Kamenica.

Në komunat tjera nuk është zgjedhur zëvendëskryesuesi i kuvendit për komunitete, pasi që përqindja e komuniteteve pakicë në këto komuna nuk arrin kuotën prej 10% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, siç parashihet me nenin 54.1 të LVL-së.

Komuna e Fushë Kosovës edhe pse ka afër 10% të komuniteteve pakicë, ende nuk e ka zgjedhur zëvendëskryesuesin e kuvendit për komunitete.

Gjithashtu në komunën e Ferizajt, edhe pse ekzistojnë 10% të komuniteteve pakicë në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë, pozita e zëvendëskryesuesit të kuvendit për komunitete ende nuk është rezervuar me arsyetimin se nuk përmbushen kriteret e parapara në nenin 54 të LVL-së.

Komuna e Ferizaj, e poashtu komuna e Vitisë kanë bërë shkelje të nenit 54.1 të LVL-së, sepse zëvendëskryesues të kuvendit për komunitete e kanë zgjedhur pjesëtarin nga radhët e komunitetit shumicë, e jo nga radhët e komunitetit pakicë siç parasheh Ligji.

Në bazë të raporteve të monitorimit, MAPL konstaton se, jo në të gjitha komunat kanë respektuar procedurat për zgjedhjen e zëvendëskryesuesit të kuvendit për komunitete.

Meqenëse ende nuk është bërë regjistrimi i popullsisë dhe nuk ekzistojnë të dhëna të sakta mbi numrin e banorëve të të gjitha komuniteteve në Kosovë, MAPL ka hasur në vështirësi sa I përket zbatimit të ligjshmërisë së vendimeve që kanë të bëjnë me zgjedhjen e zëvendëskryesuesit për komunitete.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale zëvendëskryesuesi për komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, në mënyrë që ë apo vendimet e kuvendit të komunës të mos i cenojnë të drejtat e tyre kushtetuese. Nga kjo rezulton se zëvendëskryesuesi ka të drejtë që ë apo vendimet e tilla t'ia paraqes për rishqyrtim kuvendit të komunës. Deri tani kemi vetëm një rast dhe atë në Komunën e Gjakovës ku zëvendëskryesuesi i kuvendit për komunitete ka kërkuar që të bëhet ndryshimi i përbërjes së anëtarëve në Komitetin për Komunitete.

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës, si organ më i lartë që është, mban mbledhje të rregullta, mbledhje të jashtëzakonshme si dhe mbledhje apo tubime publike me qytetarë.

Sipas nenit 43.2 të LVL-së, Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Kjo mund të përcaktohet edhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Seancat e kuvendit të komunës

Pas konstituimit dhe funksionalizimit të kuvendeve komunale, të gjitha komunat e Republikës së Kosovës kanë mbajtur seancat e rregullta, duke zhvilluar normalisht veprimtarinë e tyre legislative.

Sipas nenit 43.2 të LVL-së, kuvendi i komunës mbanë së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Në bazë të raporteve të monitorimit, konstatohet se pothuajse të gjitha komunat, me

kohë kanë mbajtur seancat e rregullta. Këtu duhet përjashtuar komunën e Dragashit, Gjilanit, Obiliqit të cilat kanë mbajtur nga 4 seanca të rregullta dhe komuna e Prizrenit e cila nuk ka mbajtur asnjë seancë të rregullt.


Në këtë periudhë të raportimit (janar-qershor 2010), tetë seanca të rregullta ka mbajtur Kuvendi i Komunës së Graçanicës. Nga shtatë seanca të rregullta janë mbajtur në këto komuna: Hani Elezit, Malishevë, Mamushë dhe Prishtinë. Nga gjashtë seanca kanë mbajtur: Fushë Kosova, Gjakova, Istogu, Juniku, Kaçaniku, Klina, Mitrovica, Novobërda, Rahoveci, Skenderaj, Vitia, Vushtrria. Nga pesë seanca kanë mbajtur: Ferizaj, Deçani, Glogoci, Kamenica, Lipjani, Peja, Podujeva, Shtërrpca, Shtimja, Ranillugu dhe Suhareka. Nga katër seanca kanë mbajtur: Dragashi, Gjilani, Obiliqi. Komuna e Prizrenit nuk ka mbajtur asnjë seancë të rregullt.

Nga kjo rezulton se numri i përgjithshëm i seancave të rregullta të mbajtura në këtë gjashtëmujor është 175.

Për komunat: Zubin Potok, Lepsaviq, Zveçan dhe Klokot nuk kemi të dhëna.

Në vazhdim do të paraqesim grafikun për krahasimin e numrit të mbajtjes së mbledhjeve të kuvendeve komunale për periudhat e njëjta kohore, të gjashtëmujorit të parë të vitit 2009 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2010, nga i cili janë nxjerrë edhe statistika të ndryshme. Mirëpo në këtë analizë nuk përfshihen komuna e Graçanicës dhe e Klokotit, pasi që këto komuna janë themeluar në vitin 2010.

1. *Krahasimi i numrit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të kuvendeve komunale për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 me gjashtëmujorin e parë të vitit 2010.*



Nga ky grafiku numër 1 mund të shohim se shumica e komunave kanë respektuar dispozitat e Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale, respektivisht të nenit 43 pika 2, për mbajtjen e së paku pesë mbledhjeve të rregullta gjatë gjashtë-mujorit të parë të një viti.

Gjithashtu nga kjo nxjerrim edhe këto statistika:

- 11 komuna kanë rritur numrin e mbajtjes së mbledhjeve të gjashtë-mujorit të vitit 2010 në krahasim me gjashtëmujorin e vitit 2009;
- 12 komuna kanë mbajtur numër të njëjtë të mbledhjeve të rregullta të kuvendeve komunale për të dy periudhat e krahasuara. Pesë prej të cilave kanë mbajtur nga 5 mbledhje.
- Ndërsa 7 komuna kanë realizuar numër më të vogël të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta për periudhat e krahasuara.

Ndryshimin më të theksuar lidhur me respektimin e dispozitave të LVL-së, për numrin e mbajtjes së mbledhjeve për periudhat e caktuara, mund ta gjemi në Komunën e Shtërpcës dhe Komunën e Prizrenit. Përderisa komuna e Shtërpcës në periudhën e parë të vitit 2009 kishte mbajtur vetëm dy mbledhje të rregullta të kuvendit komunal, veprim ky që nuk kishte qenë në pajtim me LVL-në, në gjashtëmujorin e këtij viti ka mbajtur 5 mbledhje, duke realizuar aktivitete dhe miratuar akte të ndryshme lokale në pajtim me LVL-në.

Komuna e Prizrenit, për dallim nga gjashtë-mujori i parë i vitit 2009, në gjashtëmujorin e këtij viti ka mbajtur vetëm një mbledhje të rregullt, duke përfshirë edhe mbledhjen inauguruese pas zgjedhjeve të fundit. Në këtë mënyrë komuna e Prizrenit nuk ka arritur që të përmbushë obligimet ligjore për mbajtjen e numrit të caktuar të mbledhjeve dhe realizimin e aktiviteteve të tjera që dalin nga ligjet në fuqi.


Përveç seancave të rregullta Komunitat e Republikës së Kosovës gjatë kësaj periudhe kanë mbajtur edhe seanca të jashtëzakonshme. Njëzet e një(21) komuna kanë mbajtur nga një(1) seancë të jashtëzakonshme(K.K-Deçan, K.K-Dragash, K.K-Ferizaj, K.K-Fushë Kosovë, K.K-Glllogoc, K.K-Hani Elezit, K.K-K.K-Istog, K.K-Junik, K.K-Kamenicë, K.K-Klinë, K.K-Lipjan, K.K-Malishevë, K.-Mamushë, K.K-Obiliq, K.K-Podujevë, K.K-Rahovec, K.K-Shtime, K.K-Skenderaj, K.K-Suharekë, K.K-Ranillug dhe K.K-Vushtrri), nga dy(2) seanca të jashtëzakonshme kanë mbajtur katër(4) komuna (K.K-Gjilan, K.K-Mitrovicë, K.K-Prizren, K.K-

Shtërrenc), tri(3) seanca ka mbajtur K.K-Graçanicë, ndërsa gjashtë komuna nuk kanë mbajtur asnjë seancë të jashtëzakonshme.

Sa i përket mbarëvajtjes së punës së kuvendit, njoftimit lidhur me kohën e mbajtjes së seancave, pikave të rendit të ditës, shpërndarjes së materialit, si dhe çështjeve tjera të përcaktuara me nenin 43 të LVL-së, në përgjithësi komunat kanë vepruar konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 por megjithatë ka pasur raste kur ftesat në autoritetin mbikëqyrës (MAPL) nuk dërgohen fare (rasti të Komuna e Malishevës), dërgohen me vonesë, apo edhe kur ato dërgohen me kohë nuk kompletohen me materialet e nevojshme të mbledhjes.

Të gjitha mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë transparente për publikun. Në shumicën e komunave, seancat e rregullta të kuvendeve komunale transmetohen direkt në televizionet lokale. Kjo u mundëson qytetarëve informim të duhur lidhur me veprimtarinë dhe vendimet që ndërmarrin komunat në kontekst të realizimit të të drejtave të tyre.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat mbi numrin e seancave të rregullta dhe të jashtëzakonshme gjatë periudhës janar – qershor 2010.



Aktet e Kuvendit të komunës

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Kuvendi i Komunës mund të miratoj akte brenda fushës së kompetencave të tij. Në këtë kontekst Kuvendi i Komunës miraton këto akte: Statutin, Rregulloren e punës, Rregulloren Komunale, dhe çdo akt tjetër të nevojshëm me qëllim të funksionimit sa më efikas të komunës.

Nga data 01 janar 2010 e deri më datën 30 Qershor 2010, Komunitat e Republikës së Kosovës kanë miratuar vendime dhe rregullore nga fushat e ndryshme të veprimtarisë së tyre. Në përgjithësi shumica e këtyre akteve të nxjerra nga komuna kanë qenë të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, por edhe me ligje të tjera në fuqi. Mirëpo, megjithatë ka pasur edhe raste të evidentimit të shkeljeve ligjore.

Raste të evidentimit të shkeljeve ligjore ka pasur në këto komuna: Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Glogoc, Kaçanik, Kamenicë, Lipjan, Malishevë, Pejë, Prizren, Rahovec, Skenderaj, Viti, Gjilan dhe Ranillug. Më detalisht për rastet e shkeljeve ligjore, të dhënat i kemi paraqitur në tabelën e shkeljeve ligjore në pjesën e fundit të raportit.

Komunitat janë të obliguara me Ligj që vendimet dhe Rregulloret e miratuara në Kuvend t'i dërgojnë organit mbikëqyrës dhe MAPL-së për shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë. Në kuadër të këtij obligimi ligjor, pothuajse pjesa dërmuese e komunave, aktet e miratuara në kuvend i dërgojnë në MAPL për shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë.

Nga kjo rezulton se gjatë periudhës së raportimit Kuvendet e Komunave të Republikës së Kosovës kanë miratuar këto akte: K.K. Deçan ka miratuar 2 Rregullore dhe 21 Vendime; K.K. Dragash ka miratuar 1 Rregullore dhe 4 Vendime; K.K. Ferizaj ka miratuar 17 vendime, ndërsa nuk ka miratuar asnjë Rregullor; K.K. Fushë Kosovë ka miratuar 2 Rregullore dhe 20 Vendime; K.K. Gjakovë nuk ka miratuar asnjë Rregullore ndërsa ka miratuar 22 Vendime; K.K. Glogoc ka miratuar 3 Rregullore dhe 17 Vendime; K.K. Hani Elezit ka miratuar 2 Rregullore dhe 15 Vendime; K.K. Istog nuk ka miratuar asnjë Rregullore ndërsa ka miratuar 20 Vendime; K.K. Junik ka miratuar 1 Rregullore dhe 21 Vendime; K.K. Kaçanik ka miratuar 3 Rregullore dhe 21 Vendime; K.K. Kamenicë ka miratuar 1 Rregullore dhe 33 Vendime; K.K. Klinë ka miratuar 24 Vendime, asnjë Rregullore; K.K. Lipjan ka miratuar 1 Rregullore dhe 18 Vendime; K.K. Malishevë ka miratuar 10 Rregullore dhe 30 Vendime; K.K. Mamushë ka miratuar 3 Rregullore dhe 21 Vendime; K.K. Mitrovicë nuk ka miratuar asnjë Rregullore ndërsa ka miratuar 30 Vendime; K.K. Novobërdë ka miratuar 1 Rregullore dhe 18 Vendime; K.K. Obiliq ka miratuar 1 Rregullore dhe 38 Vendime; K.K. Pejë ka miratuar 1 Rregullore dhe 24 Vendime; K.K. Podujevë ka

miratuar 2 Rregullore dhe 12 Vendime; K.K. Prishtinë ka miratuar 8 Rregullore dhe 18 Vendime; K.K. Prizren nuk ka miratuar asnjë Rregullore kurse ka miratuar 2 Vendime; K.K. Rahovec nuk ka miratuar asnjë Rregullore ndërsa ka miratuar 7 Vendime; K.K-Shtërrpc ka miratuar 3 Rregullore dhe 15 Vendime; K.K. Shtime ka miratuar 1 Rregullore dhe 43 Vendime; K.K. Skenderaj ka miratuar 3 Rregullore dhe 28 Vendime; K.K. Suharekë nuk ka miratuar asnjë Rregullore ndërsa ka miratuar 21 Vendime; K.K. Viti ka miratuar 4 Rregullore dhe 33 Vendime; K.K. Vushtrri ka miratuar 2 Rregullore dhe 44 Vendime, K.K. Gjilan ka miratuar 1 Rregullore dhe 28 Vendime; K.K-Ranillug ka miratuar 13 Rregullore dhe 34 Vendime; K.K. Graçanicë nuk ka miratuar asnjë Rregullore ndërsa ka miratuar 23 Vendime.

Rregullorja për përdorimin e gjuhëve

Me qëllim të krijimit të një mjedisi për të gjitha komunitetet që të shprehin dhe ruajnë identitetin e tyre gjuhësor si dhe përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe të gjuhës së komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe në përputhje me nenin 9.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin Nr.02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, njëzet e pesë (25) komuna të Republikës së Kosovës e kanë miratuar Rregulloren për përdorimin e Gjuhëve.

Komunat të cilat kanë miratuar këtë rregullore janë: Deçani, Dragashi, Ferizaj, Fushë Kosova, Gjakova, Gjilani, Glogoci, Istogu, Juniku, Kaçaniku, Kamenica, Klina, Lipjani, Mitrovica, Novobërda, Obiliqi, Peja, Prishtina, Rahoveci, Shtimja, Skenderaji, Suhareka, Vitia, Vushtrria, Ranillugu.

Komunat të cilat nuk e kanë këtë Rregullore janë: Hani Elezit, Malisheva, Mamusha, Podujeva, Prizreni, -Shtërrpca dhe Graçanica.

Për komunën e Zubin Potokut, Leposaviqit, Zveçanit dhe Kllokotit nuk kemi të dhëna.

Më poshtë në formë tabelare kemi paraqitur komunat të cilat kanë miratuar Rregulloren për përdorimin e gjuhëve.

Komunat	Rregullorja për Gjuhët
Deçan	PO
Dragash	PO

Ferizaj	PO
F.Kosovë	PO
Drenas	PO
Gjakovë	PO
Gjilan	PO
H.Elezit	JO
Istog	PO
Junik	PO
Kaçanik	PO
Kamenicë	PO
Klinë	PO
Lipjan	PO
Malishevë	JO
Mamushë	JO
Mitrovicë	PO
N.Bërd	PO
Obiliq	PO
Pejë	PO
Podujevë	JO
Prishtinë	PO
Prizren	JO
Rahovec	PO
Skenderaj	PO
Suharekë	PO
Shtërpcë	JO
Shtime	PO
Viti	PO
Vushtrri	PO
Z.Potok	/
Leposaviq	/
Zveçan	/
Kllokot	/
Ranillug	PO
Graçanicë	JO

Transparenca

Transparenca është parim esencial në bazë të së cilës institucionet, e në këtë rast komunat, tërë veprimtarinë e tyre e ushtrojnë të hapur para qytetarëve. Qytetarët duhet të kenë hapësirë dhe të ndikojnë tek organet komunale në realizimin e interesave të tyre. Me qëllim të realizimit të kësaj, Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka paraparë mekanizma të drejtpërdrejtë me anë të të cilave qytetarëve u epet hapësirë dhe u krijohen kushte për realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre. Në kuadër të kësaj, bënë pjesë informimi publik dhe mbajtja e takimeve publike me qytetarë.

Sipas LVL-së, çdo komunë mban periodikisht, së paku dy herë në vit takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Në takime të tilla përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal.

Duke u bazuar në raportet e monitorimit të MAPL-së si dhe të dhënave të proceduara nga komunat, rezulton se në komunat Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Gjakovë, Junik, Glogoc, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë, Obiliq, Pejë, Prishtinë, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë dhe Vushtrri kanë mbajtur nga 1 takim publik me qytetarë. Krahas tyre, komunat Hani Elezit, Kaçanik, Mamushë dhe Novobërdë kanë mbajtur nga dy takime, ndërsa komuna e Shtimes ka mbajtur 3.

Komunat të cilat nuk kanë mbajtur asnjë tubim publik me qytetarë janë: Ferizaj, Gjilani, Istogu, Kamenica, Podujeva, Prizreni, Rahoveci, Vitia, Graçanica, Ranillugu dhe Kllokoti

Nga kjo rezulton se nga 33 sa janë funksionale, 22 komuna kanë mbajtur takime me qytetarë, ndërsa 12 komuna nuk kanë mbajtur nga asnjë. Marrë në përqindje rezulton se 64.7% e komunave kanë përmbushur obligimin ligjor sa i përket mbajtjes së takimeve publike. Këtu mund të arsyetohen komunat e reja si Graçanica, Ranillugu dhe Kllokoti, të cilat janë ende në fazën e konsolidimit të tyre. Ndërsa për komunat Z.Potok, Laposaviq dhe Zveçan nuk kemi të dhëna si rezultat i mosbashkëpunimit të tyre me Institucionet e Republikës së Kosovës.

Më poshtë, në formë tabelore kemi paraqitur të dhënat sa i përket tubimeve publike të mbajtura në komuna.

Takimet publike me qytetarë			
Nga 1 takim	Nga 2 takime	Nga 3 takime	Asnjë takim
Deçani	Hani Elezit	Shtimja	Ferizaj
Dragashi	Kaçaniku		Gjilani
F.Kosova	Mamusha		Istogu
Juniku	Novobërda		Kamenica
Drenasi			Podujeva
Klina			Prizreni
Lipjani			Rahoveci
Malisheva			Vitia
Mitrovica			Graçanica
Obiliqi			Ranillugu
Peja			Klllokoti
Prishtina			
Shtërpca			
Skenderaj			
Suhareka			
Vushtrria			

Tab.1. Të dhënat për numrin e tubimeve publike me qytetarë.

Përveç takimeve publike me qytetarë, në shumicën e komunave të Republikës së Kosovës, seancat e kuvendeve komunale transmetohen direkt në televizionet lokale.

Në kuadër të kësaj, me qëllim të forcimit të transparencës, MAPL ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ NR. 2008/09 për transparencën në komuna.

Gjithashtu, komunat obligohen që të nxjerrin Rregullore komunale për transparencë.

Sa i përket të drejtës për tu informuar dhe për të kërkuar llogaridhënie, ekziston infrastruktura ligjore dhe atë me Ligjin për qasje në dokumente zyrtare.

Kjo çështje është e rregulluar edhe me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Sipas nenit 68.5 të LVL-së çdo person mund të kontrollojë çfarëdo dokumenti që mbahet nga komuna, përveç nëse zbulimi i tillë nuk është i ndaluar sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

Në bazë të të dhënave me të cilat disponon MAPL, del se përveç komunës së Kaçanikut, në asnjë komunë tjetër të Republikës së Kosovës nuk ka pasur kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare. Nga kjo rrjedh se qytetarët janë të pa interesuar në këtë drejtim.

Rregullorja për transparencën

Sipas nenin 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës miraton Rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legislative, ekzekutive dhe administrative të komunës.

Po ashtu, me qëllim të forcimit të transparencës ne komuna MAPL-ka nxjerrë edhe Udhëzimin Administrativ Nr.2008/09 për Transparencë në komuna.

Bazuar në këtë obligim ligjor 26 komuna e kanë miratuar këtë Rregullore, ndërsa 6 komuna deri në këtë periudhë të raportimit nuk e kanë miratuar këtë rregullore.

Komunat ë cilat e kanë miratuar rregulloren për transparencë janë: Deçani, Dragashi, Ferizaj, Gjakova, Gjlani, Glogoci, Hani Elezit, Istogu, Juniku, Kaçaniku, Kamenica, Klina, Lipjani, Malisheva, Mitrovica, Mamusha, Obiliqi, Peja, Prishtina, Rahoveci, Shtimja, Skenderaji, Suhareka, Vitia, Vushtrria, Ranillugu.

Ndërsa nuk e kanë miratuar këtë Rregullore këto komuna: Fushë Kosovë, Novobërda, Podujeva, Prizreni, Shtërrpca dhe Graçanica.

Për komunat: Zubin Potok, Leposaviq, Zveçan dhe Kllokot nuk kemi të dhëna.

Në vijim, në formë tabelare kemi komunat te cilat e kanë miratuar Rregulloren për transparencën në komuna dhe ato të cilat nuk e kanë miratuar.

<i>Komunat</i>	Rregullorja për transparencë
Deçan	PO
Dragash	PO
Ferizaj	PO
F.Kosovë	JO
Drenas	PO
Gjakovë	PO
Gjilan	PO
H.Elezit	PO
Istog	PO
Junik	PO
Kaçanik	PO
Kamenicë	PO
Klinë	PO
Lipjan	PO

Malishevë	PO
Mamushë	PO
Mitrovicë	PO
N.Bërd	JO
Obiliq	PO
Pejë	PO
Podujevë	JO
Prishtinë	PO
Prizren	JO
Rahovec	PO
Skenderaj	PO
Suharekë	PO
Shtërpc	JO
Shtime	PO
Viti	PO
Vushtrri	PO
Z.Potok	/
Leposaviq	/
Zveçan	/
Klllokot	/
Ranillug	PO
Graçanicë	JO

Marrëveshjet ndërkomunale dhe të jashtme

Përveç të drejtës për të lidhur marrëveshje ndërkomunale, komunat kanë të drejtë që të lidhin edhe marrëveshje bashkëpunimi me organe të huaja të vetëqeverisjes lokale në të gjitha fushat e kompetencave vetanake komunale dhe kompetencave të zgjeruara, me përjashtim të atyre në paragrafit 2 të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Sa i përket sferës së brendshme të bashkëpunimit, marrëveshje të tilla kanë lidhur këto komuna: Gjakova, Juniku, Kamenica, Mamusha, Novobërda, Obiliqi, Prishtina, Skenderaj, Suhareka, Viti dhe Vushtrria.

Ndërsa, marrëveshje bashkëpunimi ndërkufitare kanë lidhur: Klina, Lipjani, Mamusha, Novobërda, Suhareka dhe Vushtrria.

Më poshtë janë specifikuar disa nga marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet komunave:

Komuna e Gjakovës - ka lidhur dy marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Junikut. Njëra marrëveshje ka të bëjë me rregullimin e shtratit të lumit "Ereniku" e cila është nënshkruar me datë 11.05.2010, ndërsa marrëveshja tjetër është lidhur me qëllim të shpalljes së zonës së fshatit Koshare si zonë me interes të përgjithshëm dhe vënien e sajë nën mbrojtje të veçantë, e nënshkruar me datë 04.05.2010.

Komuna e Junikut - ka lidhur një Marrëveshje të mirëkuptimit me Komunën e Gjakovës, e cila është përkrahur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Projekti "Eulog". Duke marrë parasysh se Njësia e Zjarrfikësve në komunën e Junikut nuk posedon pajisje të nevojshme teknike, me këtë marrëveshje është paraparë që, në rastet emergjente, Komuna e Gjakovës t'i dal në ndihmë Komunës së Junikut me kapacitete njerëzore dhe teknike. Marrëveshje tjetër është ajo në mes të Komunës së Junikut dhe kompanisë rajonale Hidro Drini, për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza.

Gjithashtu Komuna e Junikut ka lidhur një Marrëveshje të mirëkuptimit me Komunën e Gjakovës, e cila është përkrahur nga MAPL dhe që përfshinë rregullimin e shtratit të lumit Erenik.

Komuna e Prishtinës - gjatë kësaj periudhe ka lidhur marrëveshje me komunën e Graçanicës si komunë e re, e cila ka të bëjë me transferimin e dokumentacioneve të nevojshme.

Komuna e Skenderajt - ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi ndër-komunale me komunitat Mitrovicë dhe Vushtrri, në fushën e infrastrukturës.

Komuna e Suharekës - kuadër të bashkëpunimit ndër-komunal, është në proces të lidhjes së marrëveshjeve me Komunën e Mamushës në sferën e infrastrukturës rrugore.

Ndërsa sa i përket marrëveshjeve të komunave tjera, nuk kemi të dhëna sa i përket fushave të bashkëpunimit.

Funksionimi i Komiteteve të Kuvendeve Komunale

Komitetet e obligueshme

Organe tjera ose mekanizma shumë të rëndësishëm për funksionimin e Kuvendi të Komunës janë edhe Komitetet.

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (neni 51), Kuvendi i Komunës themelon Komitetin për politikë dhe financa si dhe Komitetin për komunitete si komitete të përhershme. Gjithashtu Kuvendi i Komunës mund të themeloj edhe komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme.

Me përjashtim të Komunës së Prizrenit të gjitha komunat tjera kanë të themeluar Komitetin për Politikë dhe Financa. Ndërsa, sa i përket Komitetit për Komunitete, këtë të fundit nuk e kanë të themeluar Komuna e Drenasit dhe e Prizrenit. Komuna e Drenasit si arsyetim për mos themelimin e Komitetit për Komunitete ka dhënë mungesën e komuniteteve pakicë në këtë komunë.

Në të gjitha komunat ku janë formuar këto komitete, përbërja e tyre reflekton përfaqësimin e të gjitha subjekteve politike në kuvend, duke respektuar renditjen e subjekteve me numër më të madh të ulëseve në kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik të komunës.

Në komunat ku është themeluar Komiteti për Politikë dhe Financa, mbledhjet e këtij të fundit janë mbajtur si më poshtë: një mbledhje ka mbajtur Komuna e Lipjanit; nga tri mbledhje kanë mbajtur komuna e Istogut, Mamushës, Obiliqit, Pejës, Podujevës, Rahovecit, Shtërpcës dhe Ranillukut, nga katër mbledhje kanë mbajtur komunat, Drenas, Gjilan, Kamenicë, Klinë dhe Prishtinë, nga pesë mbledhje kanë mbajtur komunat, Deçan, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Junik, Kaçanik, Malishevë, Mitrovicë, Novobërdë, Skenderaj, Suharekë, Shtime, Viti dhe Vushtrri, Hani i Elezit ka mbajtur gjashtë mbledhje ndërsa Komuna e Graçanicës ka realizuar shtatë mbledhje. Komuna e cila nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të këtij komiteti është Komuna e Dragashit.

Komiteti për Komunitete

Komiteti për Komunitete, është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së veprimeve të autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale për t'u siguruar se të drejtat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Në komunat ku është themeluar Komiteti për Komunitete, mbledhjet e këtij të fundit janë mbajtur si më poshtë: një mbledhje ka mbajtur Komuna e Obiliqit; nga dy mbledhje kanë mbajtur komuna e Gjilanit, Hani i Elezit, Junikut, Kamenicës, Lipjanit, Novobërdës, Shtërpçës, dhe Vitisë, nga tri mbledhje kanë mbajtur komunat; Pejë, Podujevë dhe Ranilluk, nga katër mbledhje kanë mbajtur komunat, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Istog, Klinë, Mitrovicë, Suharekë, Shtime dhe Vushtrri, nga 5 mbledhje kanë mbajtur komunat, Deçan dhe Skenderaj, kurse Komuna e Prishtinës ka realizuar gjashtë mbledhje. Komunat të cilat nuk kanë mbajtur asnjë mbledhje të këtij komiteti janë, Dragashi, Kaçaniku, Malisheva, Mamusha dhe Rahoveci.

Komitetet tjera

Përveç komiteteve të obligueshme, komunat themelojnë edhe komitete tjera, për të cilat konsiderojnë se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tyre. Gjatë periudhës janar – qershor 2010 disa nga komunat kanë themeluar komitete të tjera. Një pjesë e komunave janë në proces të themelimit të këtyre komiteteve, mirëpo shumica prej tyre nuk kanë ndërmarrë ndonjë hap konkret në këtë drejtim.

Komunat të cilat kanë themeluar komitete të tjera krahas atyre të obligueshme janë: Prishtina (6), Podujeve (5), Ferizaj (6), Fushë Kosova (1), Gjakova (1), Peja(3), Skenderaj (2), Vushtrri(1) dhe Mitrovica (3), kurse komunat që kanë deklaruar se i kanë themeluar këto komitete por nuk kanë ofruar ndonjë të dhënë për numrin apo fushë veprimtarinë e tyre janë komunat, Gjilan, Kamenicë, Klinë, Lipjan dhe Viti .

Komunat të cilat nuk kanë themeluar asnjë komitetet tjetër krahas atyre të obligueshme janë: Deçani, Dragashi, Drenasi, Hani i Elezit, Istogu, Juniku, Kaçaniku, Malisheva, Mamusha, Novobërda, Prizreni, Rahoveci, Shtime, Shtërpca, Suhareka, Graçanica, Ranillugu.

Komitetet Konsultative

Organe ose mekanizma tjerë të rëndësishme, të cilat qytetarin po ashtu e sjellin afër procesit të vendimmarrjes, janë Komitetet Konsultative (neni 73 i LVL-së). Këto Komitete janë të obligueshme për komunat, sepse përmes tyre qytetarët dhe grupet tjera të interesit, marrin pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes.

Me LVL (nenin 73.3) parashihet që anëtarësimi në këto komitete të përbëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.

Në këtë drejtim, me qëllim të krijimit apo forcimit të bazës ligjore, MAPL ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr. 2008/10 “Për organizimin dhe funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna”, me qëllim të konkretizimit të veprimeve të cilat do duhej të ndërmerreshin nga komuna me rastin e themelimit të këtyre komiteteve.

Këto komitete pra, i themelon kuvendi i komunës si komitete këshillëdhënëse sektoriale me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

